



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 788/2 Prot.

Tiranë, më 03.06.2025

V E N D I M

Nr. 141 Datë 03.06.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 119, datë 21.5.2025, e paraqitur nga z. E.L kundër Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë z. E.R , me pretendimin për diskriminim, për shkak të “gjinisë”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, pala ankuese në mes të tjerash parashtroi se, është një shtetas shqiptar, aktivist dhe studiues i të drejtave të njeriut, i shqetësuar për përdorimin e gjuhës publike që cenon dinjitetin dhe barazinë ndërmjet gjinive dhe se në përputhje me ligjin nr.10221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, paraqet këtë ankesë zyrtare ndaj deklaratës së Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, z.E.R , e bërë gjatë një takimi elektoral të zhvilluar me gratë dhe vajzat në qarkun e Dibrës.

Pala ankuese, parashtroi se, gjatë fjalës së tij publike, z.R. është shprehur: *“Nëse ne kemi 60% të grave dhe vajzave, nëse ne kemi shumicën e votuesve të parë, na mjafton vetëm gjysma e burrave, sepse kjo jetë këtu në këtë vend më ka mësuar që gjysma e burrave janë normal, gjysma tjetër janë çyrykë”*.

Ankuesi pretendon se kjo deklaratë përbën një formë të qartë të diskriminimit gjinor dhe përdorimit të një gjuhe fyese dhe paragjyquese ndaj burrave, duke përhapur stereotipe negative që ndikojnë drejtpërdrejtë në perceptimin shoqëror dhe dinjitetin e këtij grupi gjinor. Përdorimi i termit “çyryk” sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2006), fjala “çyryk” ka kuptimin: *“Njëri i pavlerë, njëri pa aftësi, i pazoti, i papërdorshëm.”* Në disa përdorime të tjera popullore ose dialektore, kjo fjalë shoqërohet edhe me konotacione përçmuese që shënojnë dikë si qesharak, i padobishëm ose jo funksional, shpesh në një mënyrë poshtëruese. Përdorimi i kësaj fjale nga një përdorues i lartë i shtetit si Kryeministri, për më tepër në një fjalim zyrtar publik, përbën, sipas ankuesit:

1. Diskriminim të drejtpërdrejtë mbi bazë gjinie, sipas nenit 3 dhe 4 të ligjit nr.10221/2010;

2. Shkelje të dinjitetit njerëzor, duke krijuar një ambient degradues dhe poshtërues për burrat si kategori shoqërore;
3. Nxitje të gjuhës së përçarjes dhe stigmatizimin ndaj një pjese të popullsisë përmes deklaratave të përgjithësuara fyese.

Gjatë proceseve zgjedhore, përdorimi i gjuhës së kujdesshme, gjithpërfshirëse dhe jo-diskriminuese është një standard thelbësor i përsëritur vazhdimisht në raportet e Bashkimit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare si OSBE/ODIHR dhe Këshilli i Evropës. Këto institucione theksojnë se mënyra si përfaqësuesit politikë komunikojnë publikisht, veçanërisht gjatë fushatave, ndikon drejtpërdrejtë në klimën sociale dhe në respektimin e parimeve demokratike dhe të të drejtave të njeriut.

Në Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, është theksuar vazhdimisht nevoja për një diskurs publik të bazuar në barazi dhe respekt. Në këto dokumente vihet në dukje se politikanët duhet të shmangin çdo gjuhë që mund të përçojë stereotipe negative apo të ofendojë grupe të caktuara të shoqërisë, përfshirë gratë, burrat, minoritetet apo komunitete të tjera të marginalizuara. Këto raporte kërkojnë nga Shqipëria të përforcojë standardet e komunikimit institucional, si një element kyç për avancimin e mëtejshëm drejt integritetit evropian.

Gjithashtu, OSBE/ODIHR në misionet e saj të vëzhgimit të zgjedhjeve në Shqipëri ka rekomanduar me forcë shmangien e gjuhës diskriminuese apo seksiste nga ana e kandidatëve dhe partive politike. Në raportet për zgjedhjet e kaluara, OSBE ka kritikuar rastet kur gjuha e përdorur ka qenë fyese ose përjashtuese, duke nënvizuar që komunikimi publik duhet të jetë i barabartë dhe respektues ndaj të gjitha gjinive dhe grupeve sociale.

Këshilli i Evropës, përmes udhëzuesve të posaçëm për gjuhën jo diskriminuese në jetën publike, thekson se zyrtarët e lartë kanë përgjegjësinë të përçojnë mesazhe që promovojnë barazi dhe respekt. Udhëzuesi nënvizon se përdorimi i stereotipeve ose fjalëve fyese, sidomos në një kontekst publik e institucional, legjitimon diskriminimin dhe ul standardin e demokracisë përfaqësuese.

Ankuesi parashtroi se, në këtë kontekst, përdorimi i termit “çyryk” nga Kryeministri E.R për të përshkruar “gjysmën e burrave”, përbën një rast të qartë të gjuhës diskriminuese/bullizuese dhe përjashtuese që bien ndesh me këto standarde. Duke qenë se gjuha politike formëson opinionin publik dhe ndikon në mënyrën si grupet e ndryshme perceptohen në shoqëri është thelbësore që figurat publike të mbajnë përgjegjësi për deklaratat e tyre.

Gjithashtu, organizata të shoqërisë civile kanë bërë thirrje disa herë për ndalimin e gjuhës së urrejtjes dhe denigruese të përfaqësuesve politikë gjatë fushatës.

Përfundimisht pala ankuese kërkon nga Komisioneri, shqyrtimin e rastit si një formë e diskriminimit gjinor publik dhe institucional, t’i kërkojë një sqarim publik dhe/ose ndjesë nga Kryeministri për gjuhën e përdorur, si dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për të garantuar që figura publike të mbahen përgjegjëse për gjuhën që përdorin në komunikimet zyrtare publike.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, (LMD) të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si: “...çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, përcaktohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 4, të ligjit LMD, përcaktohet se: “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Bazuar në nenin 32, pika 1, të LMD, përcaktohet se: “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”;

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi”.

Bazuar në nenin 33, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë

administrative. 2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës dhe mbështetur në faktet dhe pretendimet e parashtuara nga ankuesja, Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b” të LMD-së, ku përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.....”, ankesa objekt shqyrtimi nuk duhet të pranohet si e papajtueshme me dispozitat e ligjit, për arsye të mëposhtme:

Bazuar në nenin 4, të LMD të marrë së bashku me nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, janë subjekte të ligjit dhe mund t’i drejtohen Komisionerit të gjithë personat fizikë dhe juridikë, si dhe çdo subjekt i së drejtës i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Nenet 32/a dhe 33/1, të LMD-së, i njohin të drejtën çdo personi ose grupi personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose organizate me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, për të paraqitur ankesë para Komisionerit.

Këto dispozita të marra së bashku me nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, kërkojnë që një person ose grup personash të kenë një interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative. Pra në rastin konkret, që ankuesi të legjitimohet si palë në procedurën administrative para Komisionerit duhet që të ketë një interes legjitim të drejtpërdrejtë.

Ankuesi, ka denoncuar faktin se, Kryeministri gjatë një takimi elektoral të zhvilluar me gratë dhe vajzat në qarkun e Dibrës, ka përdorur një gjuhë diskriminuese për shkak të gjinisë, një gjuhë fyese, paragjyquese dhe përjashtuese ndaj burrave, duke përhapur stereotipe negative që ndikojnë në perceptimin shoqëror dhe dinjitetin e këtij grupimi gjinor.

Në këto kushte, për t’u legjitimuar për të paraqitur një ankesë pranë Komisionerit, ankuesi, duhet të provojë se cenohet në interesin e tij legjitim të drejtpërdrejtë. Pra, ankuesi duhet të provojë se cenohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga deklaratimet e bëra nga Kryeministri, gjatë takimit elektoral.

Komisioneri vëren se, në këtë ankesë, ankuesi, nuk është synuar apo etiketuar personalisht në deklaratimet e Kryeministrit të bëra gjatë takimit elektoral, por fjalët dhe shprehjet e përdorura i adresohen “burrave” në përgjithësi. Në këtë mënyrë ankuesi nuk provon se ka një interes të drejtpërdrejtë dhe personal. Ankuesi nuk mund t’i drejtohet Komisionerit për të arritur respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave apo interesave publike që i drejtohen një komuniteti në tërësi apo një grupi shoqëror. Në këto kushte për të bërë një ankesë para Komisionerit do të legjitimoheshin subjektet që janë mbajtës të interesave kolektive apo interesave të gjerë të publikut në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk provoi se ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi dhe rrjedhimisht ai nuk ka legjitimitet aktiv për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejshme për shqyrtimin e saj¹.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 119, datë 21.05.2025, të paraqitur nga z. E.L , pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: gjinia
Fusha: Të mira shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim

¹ Për analogji citojmë: Vendimet nr. 70, datë 13.07.2020 dhe nr. 79, datë 07.04.2025, të Komisionerit.